

## **RREGULLORE**

### **Mbi mënyrën e organizimit të lojës promovionale "Çdo muaj – FITUES"**

Me qëllim që të përcaktohen rregullat dhe mënyra e organizimit të lojës promovionale “Çdo muaj – FITUES” për klientët individë, të cilët përdorin ose do të jenë përdorues të rinj të platformës Digjitale Raiffeisen ON dhe kartës së debitit (VISA dhe MasterCard), gjatë periudhës 1 Mars 2022 – 31 Dhjetor 2022, Departamenti i Marketingut, Departamenti i Daily Banking dhe Card Business dhe Departamenti i PI Lending dhe Digital Banking, nxjerrin këtë Rregullore:

#### **1. Lloji i lojës promovionale**

- 1.1 Duke filluar nga data **1 Mars 2022 deri 31 Dhjetor 2022**, Raiffesen Bank Sh.a do të organizojë një lojë promovionale për klientët individë që janë përdorues të platformës digjitale Raiffeisen ON mobile si edhe përdorues të kartave Debit të lëshuara nga Raiffesen Bank.
- 1.2 Çdo muaj do të hidhet një shorte për të nxjerrë 13 fitues. Çmimet do të jepen për klientët fitues, përdorues të Raiffeisen ON mobile që kryejnë një hyrje të suksesshme nga platforma nëpërmjet celularit, si dhe një blerje të suksesshme me kartën e debitit Visa ose Mastercard në pikat e shitjes POS fizik ose internet (brenda dhe jashtë vendit) brenda muajit.
- 1.3 Në lojën promovionale do të konsiderohen të vlefshme hyrjet e suksesshme në Raiffeisen ON mobile, si dhe kryerja e suksesshme e nje transaksioni me kartë debiti Visa ose MasterCard në pikë shitje POS (përfshirë pagesat në Internet) brenda dhe jashtë vendit.

#### **2. Kohezgjatja e lojës**

- 2.1 Loja promovionale do të zhvillohet gjatë periudhës 1 Mars 2022 deri 31 Dhjetor 2022.
- 2.2 Cdo muaj do të jepen 13 çmime. Shorteu do të hidhet më datë 15 (pesëmbëdhjetë) të muajit pasardhës. Në rast se data 15 e muajit bie në ditë pushimi, shorteu do të hidhet në ditën pasardhëse të punës.
- 2.3 Ditët kalendarike janë ato ditë kur të gjithë klientët mund të aksesojnë platformën dhe të kryejnë veprime me kartë debiti.

- 2.4 Kalendarri promocional fillon më datë 1 Mars 2022 dhe mbaron më 31 Dhjetor 2022. Në rast se autorizimi jepet mbas datës 01 Mars 2022, kalendarri promocional do të fillojë nga data e dhënies së autorizimit nga AMLF.
- 2.5 Shorteu për 13 (trembëdhjetë) çmimet fituese do të hidhet në datat: 15 Prill 2022; 16 Maj 2022; 15 Qershor 2022; 15 Korrik 2022; 15 Gusht 2022; 15 Shtator 2022; 17 Tetor 2022; 15 Nëntor 2022; 15 Dhjetor 2022; 16 Janar 2023.
- 2.6 Njoftimi për orën dhe vendin e saktë se ku do të zhvillohet shorteu do të depozitohen pranë institucionit përkatës dhe organit tatimor 20 (njëzet) ditë përpara datës së zhvillimit të shorteut, sipas VKM-së në fuqi.
- 2.7 Në varësi të ecurisë së lojës promotionale saj, Raiffeisen Bank sh.a. mund të vlerësojë ndërprerjen e zhvillimit të lojës promotionale për muajt pasardhës. Në një rast të tillë, klientët do të njoftohen paraprakisht me anë të njoftimeve nëpërmjet platformës Raiffeisen ON, njoftimeve që do të publikohen në faqen zyrtare të bankës, si dhe në rrjetet sociale të bankës. Në çdo rast ndërprerja do të bëhet në fund të një periudhë 1-mujore, në mënyrë që të mos sjellë asnjë impakt për klientët që kanë plotësuar kriteret për të marrë pjesë në lojën promotionale gjatë atij muaji.

### **3. Numri i çmimeve dhe mënyra e shpërblimit të fituesve**

- 3.1 Çdo muaj do të ketë 13 fitues (gjithsej 130 fitues).
- 3.2 Çmimet që do të ofrohen për çdo muaj janë: 1 (një) aparat celular smartphone, 2 (dy) aparate smart tablet, 10 (dhjetë) kupona dhuratë me vlerë 10,000 lekë secili për blerje në rrjetin e dyqaneve të grupit “Balfin”.

### **4. Kosto për pjesëmarrësit**

- 4.1 Klientët individë që do të jenë pjesë e kësaj loje promotionale nuk kanë kosto shtesë për pjesëmarrjen në këtë promocion. Ata janë të ftuar të përdorin platformen digjitale Raiffeisen ON mobile dhe kartën e debitit sipas kushteve të përcaktuara për të qenë pjesë e shorteut.

### **5. Vlera monetare e çmimeve të ofruara**

- 5.1 Vlera monetare e çmimeve të aparateve smartphone është rreth 105,000 lekë (njëqind e pesë mijë)/aparat, vlera monetare aparateve smart tablet është rreth 45,000 lekë (dyzet e pesëmijë)/aparat, vlera e kuponave dhuratë është 10,000 lekë (dhjetë mijë)/kupon.

### **6. Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në lojë**

- 6.1 Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në lojë do të jetë rreth 20,000 klientë / muaj.
- 6.2 Probabiliteti: 0.07 % /klient

## **7. Pjesëmarrësit që kanë të drejtë të marrin pjesë në lojë. Kufizimet**

7.1 Konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në lojën promovionale (eligible) të gjithë klientët e Raiffeisen Bank Sh.a që janë përdorues të regjistruar në Raiffeisen ON mobile ose e shkarkojnë dhe aktivizojnë aplikacionin gjatë periudhës promovionale dhe janë mbajtës të kartës së debitit Visa ose Master Card të lëshuar nga Raiffeisen Bank (MasterCard në lekë ose euro ose Visa në lekë), të cilët plotësojnë kushtet si më poshtë:

- a) kanë bërë shkarkimin dhe aktivizimin e aplikacionit Raiffeisen ON mobile dhe
- b) kanë bërë një hyrje të suksesshme një herë në muaj në aplikacionin Raiffeisen ON mobile dhe
- c) kanë kryer një transaksion të vlefshëm në POS fizik ose internet (brenda ose jashtë vendit) me kartën e debitit Visa Classic ose Mastercard gjatë atij muaji;

7.2 Klientët e Raiffeisen ON mobile mund të jenë klientë ekzistues që e kanë aplikacionin të shkarkuar dhe të aktivizuar ose klientë të rinj që shkarkojnë dhe aktivizojnë aplikacionin brenda periudhës së shorteut. Klientët fitues nuk përjashtohen nga pjesëmarrja në lojën promovionale në muajt pasardhës, për sa kohë plotësojnë kushtet e pjesëmarrjes në lojën promovionale në çdo muaj deri në përfundimin e saj.

7.3 Klientët e kartës së debitit mund të jenë klientë ekzistues që e kanë kartën e debitit nga Raiffeisen Bank ose klientë të rinj që aplikojnë dhe përdorin në POS kartën e debitit brenda periudhës së shorteut.

7.4 Nuk konsiderohet hyrje e suksesshme në Raiffeisen ON mobile nëse klienti nuk ka të shkarkuar aplikacionin dhe nuk bën një hyrje të suksesshme në aplikacion mobile pas aktivizimit të tij.

7.5 Nuk konsiderohen transaksione të vlefshme me kartë për lojën promovionale ato veprime që rezultojnë të pasuksesshme ose për të cilat ka më pas veprim të kthimit mbarsht të vlerës (refund).

7.6 Staf i Raiffeisen Bank Sh.a, Raiffeisen Invest Sh.a dhe Raiffeisen Leasing Sh.a. do të përjashtohet nga ky shorte. Këtij rregulli i nënshtrohen edhe kartat shtesë për këtë kategori.

## **8. Menyra e perzgjedhjes se fituesve dhe vendi ku do te behet perzgjedhja**

8.1 Çdo muaj do të gjenerohet një listë për klientët të Raiffeisen ON mobile që plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shorteut. Midis datave 3 dhe 14 të çdo muaji, do të përpunohet informacioni për të gjithë klientët.

8.2 Shorteu do të zhvillohet në datë 15 të cdo muaji pasardhës (ose në ditën pasardhëse të punës, në rastet kur data 15 është ditë pushimi). Përzgjedhja e fituesve do të behet nepermjet një programi kompjuterik.

8.3 Shorteu do të hidhet për përcaktimin e fituesve sipas kësaj radhe: fillimisht do të përzgjidhen fituesit për 10 (dhjetë) kupona, më pas fituesit për 2 (dy) smart tablet dhe në vazhdim fituesi për 1 (një) smartphone.

8.4 Mbas shpalljes së fituesve, organizatori i lojës do të përzgjedhë edhe 2 (dy) emra të tjerë (rezervë) vetëm në prani të komisionit, për të gjitha kategoritë e çmimeve, të cilëve do t'u akordohet çmimi në rast se ndonjë prej fituesve, nuk përgjigjet, nuk paraqitet në afatin e caktuar apo refuzon çmimin e ofruar nga banka.

8.5 Shorteu do të hidhet në zyrat qendrore të Raiffeisen Bank sh.a. në adresën: Rruga “Tish Daija”, Kompleksi KIKA 2, Tirane, në orën 15:00, në datat e përcaktuara si më sipër.

## **9. Mënyra e njoftimit të fituesve**

9.1 Fituesit do të njoftohen me telefon ose e-mail nga ana e Bankës, duke ju referuar numrit të telefonit dhe adresës elektronike që klienti ka regjistruar në sistemet e Raiffeisen Bank.

9.2 Klienti fitues duhet të zgjedhë se ku do të tërheqë cmimin gjatë telefonatës që do ketë me përfaqësuesin e Raiffeisen Bank. Nëse klienti fitues nuk paraqitet në adresën e përzgjedhur nga vete klienti brenda datës 25 (njëzet e pesë) të muajit që hidhet shorteu, humb të drejtën e përfitimit të çmimit. Bankës i lind e drejta t’ia kalojë çmimin klientit tjetër të përzgjedhur si fitues.

## **10. Mekanizmi i lojës promovionale**

10.1 Çdo muaj do të krijohet një bazë të dhënash me të gjithë klientët që plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shorteut. Informacioni do të përpunohet midis datave 3 dhe 14 të çdo muaji, Fituesit e lojës promovionale do të përcaktohen me një përzgjedhje të rastësishme, nëpërmjet një programi kompjuterik.

10.2 Elementi që përcakton fituesin është Emri, Mbiemri, NRP, Qyteti/Rrethi dhe numri i kartës së debitit i maskuar që shpall kartëmbajtësin fitues.

10.3 Programi software me anë të të cilit do të bëhet përzgjedhja e fituesve është ndërtuar nga Divizioni i TI-së pranë Raiffeisen Bank. Në këtë proces është siguruar që të mos ketë ndërhyrje njerëzore, por të gjitha të dhënat gjenerohen automatikisht nga sistemi I bankingut digjital. File me të dhënat e klientëve ngarkohet në sistemin e ndërtuar, i cili zgjedh në mënyrë rastësore një emër nga lista.

## **11. Hyrja në fuqi**

11.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe është e vlefshme deri në përfundim të kësaj loje promovionale.